



VLERA E PRODUKTEVE TRADICIONALE TË BAXHOVE

Komisioni Evropian ka krijuar një mjet të dedikuar për produktet rurale/malore, gjithashtu për të mbështetur konsumatorët në zgjedhjet e tyre. Në fakt, megjithëse disa konsumatorë kishin një opinion pozitiv për produktet malore, kishte një nivel të ulët informacioni për origjinën dhe karakteristikat e këtyre produkteve, kryesisht për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së informacionit. Në Shqipëri të tilla janë edhe produktet e prodhuara nga baxhot e qumështit, që numërohen rreth 330 njësi. Këto nënprodukte e marrin origjinalitetin dhe dallueshmërinë e tyre nga një origjinë gjeografike (PDO), e cila përbëhet nga faktorë natyrorë dhe njerëzorë.



KUSH JANË KRITERET E CERTIFIKIMIT TË PRODUKTEVE TRADICIONALE NË BE?

Veçantia e një produkti të tillë (PDO) rrjedh nga rajoni i saj i origjinës. Çdo produkt ka veti specifike shqisore (shije, aroma, teksturë) të lidhura me kushtet e tyre të prodhimit dhe rajonin e tyre (lloji i tokës, përbërja e livadheve, raca lokale, klima, fermentimi i qumështit ose mënyra e pjekjes, ruajtja etj). Për të fituar etiketën PDO, prodhuesit duhet të tregojnë dhe detajojnë lidhjen midis produktit, dallueshmërisë së tij dhe rajonit të origjinës. Në Shqipëri ky proces ka filluar dhe subjektet e vogla të përpunimit të qumështit duhet të fillojnë të mendojnë të investojnë për plotësimin e standardeve dhe të aplikojnë për certifikimin “Produkt Tradicional” pranë Ministrisë së Bujqësisë.



1). Emërtimi i origjinës së mbrojtur (PDO)

Emrat e produkteve të regjistruara si PDO janë ato që kanë lidhjet më të forta me vendin në të cilin janë bërë.

Produktet: ushqimore, produkte bujqësore.

Specifikimet: Çdo pjesë e procesit të prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes duhet të zhvillohet në rajonin specifik.

Etiketa: e detyrueshme për produktet ushqimore dhe bujqësore, opsionale për verën.



2). Treguesi gjeografik i mbrojtur (PGI)

PGI thekson marrëdhënien midis rajonit specifik gjeografik dhe emrit të produktit (psh Djathë Kaçkavall Gjirokastrë), ku një cilësi, ose karakteristikë tjetër i atribuohet në thelb origjinës së tij gjeografike.

Produktet: ushqimore, produkte bujqësore.

Specifikimet: Për shumicën e produkteve, të paktën një nga fazat e prodhimit, përpunimit ose përgatitjes zhvillohet në rajon.

Etiketa: e detyrueshme për ushqime, produkte bujqësore, opsionale për verërat.



“NOA FINANCON, NOA KËSHILLON”